

AEROPORTI I KUKËSIT

Në 18 Prill fluturimi i parë nga Kukësi

Ministrja Belinda Balluku zhvilloi një takim informues mbi zhvillimet në aviacionin civil në mënyrë të veçantë vënien në funksion të aeroportit të Kukësit, mbylljen e procedurave për ndërtimin e aeroportit të Vlorës dhe ndryshimi kontratës së koncesionit për aeroportin e Rinasit.

Prezente në takim, Drejtoresha e Autoritetit të Aviacionit Civil, Znj. Edlira Kraja bëri një përditësim të situatës dhe sqaroi në lidhje me procesin e certifikimit të Aeroportit të Kukësit.

“Autoriteti i Aviacionit Civil po realizon procesin e certifikimit, siç është e parashikuar dhe në bazën rregullatore, në Kodin Ajror të Republikës së Shqipërisë dhe të gjitha aktet nënligjore që kemi veçanërisht të dedikuara për operimet në aeroporte. Që një aeroport të jetë operacional duhet ti nënshtrohet procesit të certifikimit, pra vlerësimit të përshtatshmërisë të të gjithë komponentëve që ka një aeroport, me standardet që ne kemi në fuqi që janë përshtatje e standardeve ndërkombëtare të ICAO-s. Konkensionari i Aeroportit të Kukësit ka aplikuar zyrtarisht për tu pajisur me certifikatë nga Autoriteti i Aviacionit Civil. Në AAC është ngritur grupi i posaçëm për certifikimin e Aeroportit që do të ketë një ekspertizë komplekse nga Security, Safety, Operimi i Aerodromeve dhe Shërbimi i Lundrimit Ajror sepse paralelisht me certifikimin e operimeve në aeroportin e Kukësit do të bëhet dhe një amendim në certifikatën e ofruesit të shërbimit ajror.



Bashkë me aplikimin e koncensionarit ka ardhur dhe një pjesë e mirë e bazës dokumentare, ku do të përmendja Manualin e Aerodromit që është dokumenti kryesor ku përshkruhen të gjitha operacionet që do të kryhen në aerodrom, mënyra se si do të kryen në përshtatje me infrastrukturën që do të ekzistojë atje dhe me pajisjet që do të instalohen. Është dorëzuar Programi i Sigurisë i Aeroportit, që edhe ai është një dokument shumë i rëndësishëm që përshkruan se si shërbimi i sigurisë dhe siguria në aviacion do të garantohet në atë aeroport.

Është paraqitur struktura organizative, se si koncensionari mendon që do ta menaxhojë aeroportin së bashku me kandidaturat për pozicionet kyçe që do të menaxhojnë operimet në këtë aeroport. Kandidatura që po vlerësohen për përshtatshmërinë e tyre me kriteret që kemi ne në fuqi për këto poste.

Krahas vlerësimit të bazës dokumentare do të bëhet dhe auditimi, është kryer një inspektim gjatë muajit Shkurt në aeroportin e Kukësit dhe do të bëhet një auditim i përgjithshëm në muajin Mars, paralelisht me auditimin që do të bëhet nga Albcontrol, auditim i cili do të vlerësojë jo vetëm infrastrukturën dhe pajisjet, por edhe adaptueshmërinë që do të ketë personeli i aeroportit të Kukësit me këto pajisje dhe manualin që ka dorëzuar në AAC.

Ky proces është hallka që i paraprin vendimmarrjes përfundimtare, vlerësimit përfundimtar që do të bëjë grupi i certifikimit për përshtatshmërinë që kanë të gjithë këta komponentë me bazën rregullatore që ne kemi në fuqi, me kërkesat dhe standardet në fuqi.

Është një proces kompleks, i cili ka në vetvete jo vetëm shkëmbim eksperience dhe ekspertize,

por ka dhe një koordinim dhe një ndërveprim intensiv midis aktorëve që është koncensionari si aplikues, Autoriteti i Aviacionit Civil si rregullator dhe si certifikues edhe ofruesi i shërbimit të lundrimit ajror, Albcontrol.

Nga ana e koncensionarit ka patur një angazhim serioz, ai ka reaguar në kohë me adresimin e rekomandimeve që ka bërë grupi i certifikimit për atë që ka vlerësuar deri tani dhe mendoj që jemi në fazë të avancuar të procesit të vlerësimit dhe shpresojmë që me gjithë këto hallka dhe veprime, të arrijmë të kemi një aeroport të gatshëm për të qenë operacional brenda objektivit të vendosur," tha Znj. Kraja

Ministrja Balluku tha "Për Aeroportin e Kukësit, kemi bërë testet e para të ulje ngritjeve, jemi në fazat përfundimtare pista dhe terminali, kemi nisur nga puna prej kohësh, jemi në finalizimin e hapave që do hedhim në aeroportin e Sarandës. Askush nuk ka besuar se do të kishim një dorëzim të aeroportit të Kukësit në 24 muaj. Nga ç'jemi njoftuar fluturimi i parë parashikohet me datë 18 prill. Nga një aeroport po punojmë për një tjetër dhe në 5 vite duam të mbarojmë 4 aeroporte. Do të ishte mirë që në UT të kishim një degë dedikuar fushës së aviacionit."

Ministrja përmendi dhe projektin ku po punohet intensivisht për Aeroportin e Vlorës ku pas shpalljes së kompanisë fituese të koncesionit është parashikuar edhe data kur do të nisin punimet. Punimet për aeroportin e Vlorës pritet që të nisin 5 ditë përpara zgjedhjeve të 25 Prillit.

Ministrja Balluku ndau me pjesëmarrësit dhe një lajm të mirë në lidhje me fluturimet dhe turizmin.

Duke nisur nga data 28 Mars, nisin fluturimet direkt, dy herë në javë, Tiranë-Dubai, nga kompania Flydubai

Inspektim i panjoftuar në departamentin e Cargo-s

Autoriteti i Aviacionit Civil kreu një inspektim të panjoftuar pranë Aeroportit Ndërkombëtar “Nënë Tereza”, me qëllim verifikimin e zbatueshmërisë së masave të sigurisë në Agjentin e Rregullt për kargon dhe postën ajrore TIA-RA.

Në kushtet e pandemisë globale, ndryshe nga transporti i pasagjerëve që pësoi rënie të dukshme, transporti i kargos dhe postës ajrore ka vazhduar punën me të njëjtin intensitet.

Është detyra e të gjithë aktoreve të përfshirë në këtë transport, të zbatojnë me rigorozitet masat e sigurisë në transportimin e kargos. Është detyra e AAC të monitorojë në mënyrë konsistente përputhshmërinë e masave të zbatuara nga entitetet TIA RA (Regulat ed Agent), me standardet dhe praktikat e rekomanduara.



Inspektimet SAFA

Autoriteti i Aviacionit Civil kreu një inspektim SAFA (Safety Assessment Foreign Aircraft) të panjoftuar pranë Aeroportit Ndërkombëtar Nënë Tereza. Sefa inspection është program i EASAs (European Union Aviation Safety Agency) për mbikqyrjen e Avioneve të vendeve të EU. Kjo detyrë është një nga pikat kryesore të programit vjetor të mbikqyrjes së AAC që mban standarte të larta të SAFETY.

Profesionalizmi dhe kryerja e inspektime SAFA- SANA nga inspektorët e Drejtorisë DMSOOA pranë AAC është e njëjtë me standardet e EU SAFA inspectors. Inspektori duhet të kryejë trajnime të vazhdueshme vjetore dhe ato përsëritëse për të ruajtur të drejtën e inspektimit. Është një program shumë i rëndësishëm për të mbajtur këtë titull në Shqipëri dhe në EU



Njoftohet zgjedhja e Sekretarit të ri të Përgjithshëm të ICAOs

Z. Juan Carlos Salazar (Kolumbian) është zgjedhur Sekretar i Përgjithshëm i ICAOs, duke pasuar Dr. Fang Liu mandati i së cilës mbaron më 31 korrik 2021. Kështu njoftoi më datë 25 shkurt 2021, Presidenti i Këshillit të ICAOs Z. Salvatore Sciacchitano

Mandati tre vjeçar i Z. Juan Carlos Salazar do fillojë më 1 gusht 2021 dhe do vazhdojë deri më 31 korrik 2024.

Z. Salazar është një ekspert i legjislacionit të ajrit dhe drejtues i nivelit ekzekutiv në aviacionin civil, me mbi 26 vjet përvojë unike në negociatat e aviacionit ndërkombëtar, menaxhimin dhe politikat publike. Ai është Drejtor i Përgjithshëm (CEO) i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kolumbisë. Ai ka diplomë të avancuar nga Universiteti i Harvardit (Master në Administratën Publike - MPA) dhe nga Universiteti McGill (Master në Drejtësinë e Ajrit dhe Hapësirës - LLM), zotëron shumë mirë gjuhët Spanjisht, Anglisht, Frengjisht dhe flet Arabisht.



					
International Civil Aviation Organization	Organisation de l'aviation civile internationale	Organización de Aviación Civil Internacional	Международная организация гражданской авиации	منظمة الطيران المدني الدولي	国际民用 航空组织

PRES SS/3143 25 February 2021

To: All Staff Members
From: President of the Council
Subject: **Appointment of the Secretary General**

I am pleased to inform you that on today's date, during the third meeting of its 222nd Session, the Council appointed Mr. Juan Carlos Salazar (Colombia) as Secretary General of the Organization to succeed Dr. Fang Liu whose term expires on 31 July 2021.

Mr. Juan Carlos Salazar's three-year term will begin on 1 August 2021 and continuing until 31 July 2024.


 Salvatore Sciacchitano

999 Robert-Bourassa Boulevard Tel.: 514-954-8219 Email: icao@icao.int
 Montréal, Quebec Fax: 514-954-6077 www.icao.int
 Canada H3C 5H7

LAJME / VEPRIMTARIA RREGULLATORE

Është miratuar nga Qeveria me VKM Nr.90, datë 17.2.2021, Plani Kombëtar për Integrimin Evropian, 2021-2023 (PKIE 2021-2023), ku një kapitull i veçantë (KAPITULLI 14), i është kushtuar çështjeve të politikës së transportit dhe posaçërisht transportit ajror.

Në këtë dokument madhor vrehet se "Në transportin ajror, faza e I e Marrëveshjes Shumëpalëshe për Krijimin e një Zone të Përbashkët të Aviacionit Evropian (ECAA), po zbatohet, në përputhje me kushtet e përcaktuara në protokollin I të kësaj Marrëveshjeje. Me vendimin nr.1/2019, datë 31 korrik 2019, të Komitetit të Përbashkët të kësaj marrëveshjeje, është miratuar zëvendësimi i aneksit I të saj, botuar në Fletoren Zyrtare të BE-së, L.211/4, datë 12.8.2019" dhe se gjatë vitit 2020 janë miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë ligji nr.96/2020, datë 23.7.2020, Këshilli i Ministrave dhe Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë edhe katër akte nënligjore, që përafrojnë akte të BE-së, si më poshtë:

-Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020 "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil" (Përafrim me Rreg. e Komisionit (BE) nr. 2018/1139, datë 04.07.2018); linku <http://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/12/24/1095>

-Urdhri i ministrit nr.59, datë 31.1.2020, "Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative për operimet ajrore" (Përafrim me Rreg. (KE) nr.216/2018 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 5 tetor 2012, të ndryshuar; linku <http://qbz.gov.al/eli/urdher/2020/01/30/59>

-Urdhri i ministrit nr.141, datë 16.4.2020, " Për miratimin e rregullores mbi parashtimin e kërkesave të përdorimit të hapësirës ajrore dhe procedurat operationale në lidhje me lundrimin ajror në bazë të performancës" (Përafrim me Rregulloren Zabtuese të Komisionit (KE) nr.2018/1048 e datës 18 korrik 2018; linku <http://qbz.gov.al/eli/urdher/2020/04/16/141>

-Urdhri i ministrit nr.167, datë 4.6.2020 "Për miratimin e rregullores mbi vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionit dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike dhe mbi miratimin e organizatave dhe personelit të përfshirë në këto detyra" (Përafrim me Rreg. e Komisionit (BE) nr.1321/2014, datë 26 nëntor 2014, të ndryshuar.

linku https://qbz.gov.al/share/QktcpzeUTJSSavkMNjq_gw

Si një ndër institucionet përgjegjëse për Kapitullin 14, në çështjet e transportit ajror, Autoriteti i Aviacionit Civil, do vazhdoj të punoj për implementimin e akteve rregullatore brenda fushës së përgjegjësisë dhe prioriteteve që do detajohen në dokumentin mbi Strategjinë Kombëtare të Transportit për periudhën 2021-2026.

Të plotë VKM Nr.90, datë 17.2.2021 e gjeni në <http://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/02/19/151>

Aeroporti Heathrow në UK raporton 2 miliardë £ humbje si pasojë e ndikimit 'shkatërrues' të pandemisë

E mërkurë, 24 shkurt 2021

Dikur aeroporti më i madh i Evropës, Heathrow pësoi një humbje vjetore prej 2 miliardë paund (2.8 miliardë dollarë) në vitin 2020, pasi numri i pasagjerëve ra dhe pandemia shkaktoi një dëm të madh në industrinë e udhëtimeve.

Heathrow Airport Holdings, kompania që drejton shërbimet në këtë aeroport, nënvizoi "ndikimin shkatërrues të COVID-19 në aviacion" pasi numri i pasagjerëve u ra në 22.1 milion, nivele këto që nuk janë parë që nga vitet 1970.

Të ardhurat e përgjithshme ranë 62% në 1.2 miliardë dhe të ardhurat neto (EBITDA) ranë me 270 milion £. "Ne nuk kemi pasur asnjë mbështetje qeveritare, përveç lejës, dhe nuk na është dhënë lehtësim për normat e biznesit, ndryshe nga aeroportet e tjera, bizneset me pakicë dhe restaurantet, klubet, hotelet, rezortet," tha Aeroporti Heathrow në një deklaratë.

"Ne mund të jemi shpresëdhënës për 2021, pasi Britania po bëhet gati që të jetë vendi i parë në botë që do të rifillojë në mënyrë të sigurt udhëtimet dhe tregtinë ndërkombëtare në nivel kombëtar", tha CEO i Heathrow John Holland-Kaye.

Ai shtoi se kryeministri Boris Johnson do të ketë "mundësinë unike" për të siguruar marrëveshje globale mbi një standard të përbashkët ndërkombëtar për udhëtimet kur ai të presë takimin e G7 në qershor 2021.

Kompania tha gjithashtu se u pa një rënie prej 28% të vëllimeve të cargos.

Marrë me shkurtime nga:

<https://uk.style.yahoo.com/heathrow-reports-2-bn-loss-amid-devastating-impact-of-pandemic-085808927.html>



TELEKONFERENCË E DREJTORËVE TË PËRGJITHSHËM TË AVIACIONIT CIVIL ME TEMË PËR SHPËRNDARJEN E VAKSINËS

Dy ishin objektivat e kësaj telekonference, së pari diskutimi i çështjeve që kanë të bëjnë me transportimin e vaksinës COVID-19 në rrugë ajrore dhe së dyti shkëmbimi i eksperiencës dhe nxjerrja e mësimave.

96 pjesëmarrësve nga 30 Shtete, 7 Organizatave Ndërkombëtare dhe Rajonale dhe 3 Operatorëve Ajror ju bashkua dhe përfaqësuesi i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Shqipërisë. Konferenca nënvizoi rëndësinë dhe afatet kohore të këtij takimi për mbështetjen e përpjekjeve globale për transportimin e vaksinave.

Në lidhje me çështjen e parë, vendosja në skenën e shpërndarjes së vaksinës në rrugë ajrore, diskutantët sollën përvojat e tyre dhe vlerësuan garantimin e Lirisë së 7të të trafikut ajror nëpërmjet marrëveshjeve

dy dhe/ ose shumëpalëshe për lejimin e fluturimeve cargo pa kufizime në rrugë dhe kapacitete, si dhe të transportuesve ajror të huaj që mund të transportojnë së bashku pasagjerë dhe cargo. Njohën progresin e punës së ICAOs për dixhitalizimin e kargos ajrore, me qëllim uljen e kontakteve fizike ndërmjet pjesëmarrësve



në tregtinë ndërkombëtare dhe operimet e transportin brenda konceptit të Korridorit të Shëndetit Publik të ICAOs, në përgjigje të pandemisë.

Lidhur me aspektet e sigurisë në operim (safety), Konferenca u ndal në përditësimin e çështjeve si klasifikimi i vaksinave si mallra të rrezikshme, gjurmimi dhe kontrolli i temperaturës (frigoriferët, akulli). U nënvizua se në lehtësimin e transportit të vaksinës, shtetet nuk duhet të neglizhojnë sigurinë në operim (safety). Lidhur me aspektet e sigurisë së aviacionit, u konkludua që për sigurinë e vaksinave transportimi të kryhet përmes procesit të zinxhirit të sigurtë të furnizimit të shtetit. Në këtë kuadër EUR/NAT - nxit shtetet që të implementojnë masat e mëposhtme:

- a)** identifikim të prodhuesëve, entiteteve të shërbimeve në tokë dhe transportimit dhe ndihmën e tyre në ofrimin e informacionit për procesin e miratimit të Dërguesit e Njohur/Agjentëve të Rregullt;
- b)** konsiderim për dhënien me urgjencë të miratimit statusit të Dërguesit të Njohur për ambiente për vaksinat COVID-19, duke marrë në konsideratë edhe të tjerë subjekte të përfshirë në regjimet ekzistuese të zinxhirit të furnizimit nga autoritete të tjera kombëtare si psh: rregullatorët Farmaceutikë, Autoritet Doganore, etj;
- c)** deri sa të jetë dhënë statusi i Dërguesit të Njohur, të merren në konsideratë masat alternative/përrjashtimet e përkohëshme nga skanimi i dërgesave të vaksinave COVID-19 bazuar në vlerësimin kombëtar të riskut.

Sa i përket nevojës së lehtësimit të koordinimit midis departamenteve, agjencive dhe organizatave të tjera të Shtetit, Konferenca risolli në vëmendje dispozitat e Aneksit 9 të ICAOs dhe në veçanti ato për ngritjen e trupave koordinues si Komitetet Kombëtare të Lehtësimit të Transportit Ajror, Komitetet e Lehtësimit në Aeroporte, ose trupave të ngjashëm. Në dritën e pandemisë dhe të ngarkesës në transportimin dhe shpërndarjen e vaksinave thelbësor mbetet koordinimi dhe bashkëpunimi ndërmjet palëve, duke përfshirë autoritetet e shëndetit publik në nivel kombëtar dhe lokal.

Pë pikën e dytë të axhendës, pjesëmarrësit patën mundësinë të njihen me eksperiencën dhe praktikën më të mira të zbatuara në Izrael, në organizimin e programit të imunizimit, i cili ka nisur në Dhjetor 2020 dhe po kryhet me shumë sukses.

Ndërkaq eksperiencën të suksesshme ndanë me pjesëmarrësit edhe përfaqësuesit e Hollandës dhe kompanisë ajrore KLM nga këndvështrimi i vështirësive të kapërcyera në transportimin e vaksinave siç janë ato të njoftimeve në minutat e fundit, sasia e madhe që kërkohet për akull, përballimi i volumeve të shtuara në një kohë të shkurtër, çështjet e temperaturës dhe risqet e sigurisë së aviacionit. Përfaqësuesi i Administratës Federale të Aviacionit (FAA/SHBA) gjithashtu solli eksperiencën e suksesshme në koordinimin e punës së palëve të përfshira në proceset e shpërndarjes së vaksinave, në marrjen e informacionit për levizjen e vaksinave, gjurmimin dhe lehtësimin e fluturimeve të cilat kërkojnë shërbime të veçanta në tokë, prioritizime në trafikun ajror, mbështetje logjistike të gjithanshme. Po ashtu u ndoqen me interes paraqitjet e përfaqësuesve të EASA dhe IATAs.

Lista e pjesëmarrësve dhe një Përmbledhje e plotë e konkluzioneve dhe të gjitha Prezantimet e paraqitura në PowerPoint mund të gjenden në faqen e ICAOs në lidhjen:

[https://WWW.icao.int/EURNAT/Pages/EUR-NAT Meetings/EURNAT-DGCA Meetings](https://WWW.icao.int/EURNAT/Pages/EUR-NAT%20Meetings/EURNAT-DGCA%20Meetings)

Përgatiti: Bujar Hazizaj



ECAC Meetings in March are organized virtually

- 2-3 32nd meeting of the Explosives Detection Dogs Study Group (EDD/32)
- 3-5 Best Practices for Drafting Technical Specifications for Security Equipment (BP-DTSE/1)
- 10 11th meeting of the Economic Working Group (ECO/11) 11 6th meeting of the Network of Chief Economists (NCE/6)
- 11 33rd COVID-19 European coordination meeting (ECM/33)
- 11-12 46th meeting of the Training Task Force (TrTF/46)
- 17 53rd meeting of the Air Accident and Incident Investigation Group of Experts (ACC/53)
- 17 3rd meeting of the ad hoc group on cyber security for screening equipment (CYBER-EQT/3)
- 22-24 Best Practices for Drafting Technical Specifications for Security Equipment (BP-DTSE/2)
- 25 190th meeting of the Coordinating Committee (CC/190)
- 29-30 Best Practices for Drafting Technical Specifications for Security Equipment (BP-DTSE/3)
- ... 36th and 37th meetings of the European Aviation and Environment Working Group (EAEG/36 & EAEG/37)
- ... 12th and 13th meetings of the APER Task Group (APER-TG/12 & APER-TG/13)
- ... 1st meeting with State Action Plans Focal Points
- ... 34th meeting of the Aircraft Noise Modelling Task Group (EAEGAIRMOD/34)

NË KËTË NUMËR BULETINI MUJOR SHKURT 2021

- Aeroporti Nderkombetar i Kukesit
- Inspektim i panjoftuar në departamentin e Cargo-s
- Inspektimet SAFA
- Njoftohet zgjedhja e Sekretarit të ri të Përgjithshëm të ICAOs
- Aeroporti Heathrow në UK raporton 2 miliardë £ humbje si pasojë e ndikimit 'shkatërrues' të pandemisë
- TELEKONFERENCË E DREJTORËVE TË PËRGJITHSHËM TË AVIACIONIT CIVIL ME TEMË PËR SHPËRNDARJEN E VAKSINËS



AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL



KONTAKT

ZYRA QËNDRORE

Rr. "Sulejman Delvina" P.O Box 205

Tiranë, Shqipëri

TEL: +355 4 225 12 20

WEB: www.aac.gov.al

EMAIL: info@acaa.gov.al



SEKTORI PËR TË DREJTAT E PASAGJERIT

TELEFON: +355 42 381 959

+355 44 539 959

EMAIL: pax@acaa.gov.al



REDAKTOI

Z. Bujar Hazizaj - Koordinator për të
Drejtën për Informim

EMAIL: Bujar.Hazizaj@acaa.gov.al

Znj. Edlira Saliq - Këshilltare për Median

EMAIL: Edlira.Saliq@acaa.gov.al



MEDIA SOCIALE



facebook.com/AlbanianCAA

autoriteti.aviacionit.civil